



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 11 mars 2019, në mbledhjen e XVII (shtatëmbëdhjetë) - e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm, nga 35 këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës, prezent ishin 32, munguan znj.Fatlume Jaha dhe Donjeta Jakupi, kurse një anëtar nuk është zëvendësuar ende nga KQZ (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i Ditës

I caktuar sipas thirrjes së kësaj mbledhje të jashtëzakonshme të iniciuar nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së përmes 13 nënshkrimeve, dhe atë me pikën si në vijim:

- **Diskutim dhe miratim i deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore.**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj se rendi i ditës i kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme është caktuar nga grupi prej 13 këshilltarëve të nënshkruar. Ftoj iniciuesin e kësaj mbledhje, që të marr fjalën hyrëse. Paraprakisht kërkojë nga diskutuesit në mënyrë strikte t'i përmbahen rregullores së Punës së Kuvendit.

znj.Doruntina Hasani, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që mundësuan që kjo seancë të thirrej, edhe pse ishte paraparë që kjo seancë të mbahej me datën 8 që do të ishte më kuptimplotë dhe më përmbajtjesore, mirëpo për disa shkaqe kjo seancë u shty me datën 11-të. Së pari dua të sqaroj se seancë e jashtëzakonshme është vetëm në terminologji për shkak se thirret jashtë mbledhjes së rregullt dhe ju kërkoj që kësaj teme mos tja zbehim rëndësinë, e them këtë dëgjova disa prej juve duke thënë se gruaja nuk është temë e jashtëzakonshme, e që fjalë të tilla ne vajzave dhe grave na bëjnë të ngritemi sa më shumë për kauza tona. Marsi Shqiptar ka domethënie të shumëfishtë: protesta, demonstrata, marshe që e karakterizojnë këtë muaj me dekada. Marrë parasysh kontributin e vajzave dhe grave në këto procese në nuk do të donim që kjo datë të kalonte vetëm me simbolikën e 8 Marsit, ne duhet të angazhohemi çdo ditë për të drejtat e Grave. Duke parë rëndësinë që të ketë sa më shumë gra që

përfshihen në sferën publike e politike dhe domosdoshmërinë që të zhvillohen politika të mirëfillta feministe, politika të cilat do të ndryshojnë aktualitetin, gjendjen e përgjithshme të grave dhe vajzave, duhet bashkim dhe përfshirje sa më e madhe e grave dhe vajzave. Shoqëria nuk mund të këtë progres pa pjesëmarrje dhe përfshirje sa më të madhe të grave, prandaj këtu kam një deklaratë me disa rekomandime që shpresoj se do të gjejnë mbështetjen e të gjithë asamblistëve. Duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 24, Ligjin për Barazi Gjinore nr.05/L-020, Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nr.03/L-18, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr.05/L-021. Duke pasur parasysh se pabarazia në një masë të madhe është sistemore, ajo vjen edhe nga qeverisja lokale, e cila nuk i zbaton ligjet të sipër përmendura. Komuna ka resurse e mekanizma dhe brenda kompetencave të veta dhe mund të bëj punë shumë më efikase në luftimin e pabarazisë, për arsye se shërbimet që i ofron Komuna prekin direkt jetën e qytetarëve. Duke qenë kështu, politikat dhe shërbimet lokale mund dhe duhet të orientohen edhe në funksion të eliminimit të pabarazisë gjinore. Duke pasur parasysh se çdo vendim i Komunës ka impakt tek qytetarët, dhe specifikisht tek gratë dhe vajzat, në planifikimin dhe ndarjen e buxhetit, duhet të përfshihen në mënyrë të veçantë gratë dhe të zbatohet praktika e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Politikat dhe indikatorët gjinorë mund të konkretizohen në investime në infrastrukturë e shërbime publike, çerdhet që kontribuojnë në fuqizimin e grave, ndriçimi publik në sigurinë për gratë dhe fëmijët, strehimoret dhe ndarja e fondeve të veçanta, e shumë aktivitete e politika tjera lokale. Nisur nga kjo dhe me qëllim që kjo ditë të shërbejë si një rast i ndërgjegjësimit institucional për pabarazinë gjinore dhe domosdoshmërinë që në punën tonë të përditshme, politikat dhe vendimet e Komunës, të mbahet gjithnjë në fokus synimi për barazi gjinore në mes grave e burrave, vajzave e djemve, në Kuvendin e Komunës, Lëvizja Vetëvendosje kërkon të miratohen rekomandimet në vijim:

- 1-Gjatë planifikimit të buxhetit të Komunës të zbatohet mekanizmi për buxhetim të përgjegjshëm gjinor;
- 2-Të fuqizohet Zyra për barazi gjinore përmes buxhetit shtesë, të miratohet Plani gjinor i veprimit dhe të raportojë në Kuvendin e Komunës një herë në vit për punën dhe aktivitetet;
- 3-Të përkrahen gratë në biznes dhe subvencionim i iniciativave lokale të grave;
- 4-Formimi i Komitetit për barazi gjinore si trupë e Kuvendit të Komunës.
- 5-Formimi i një mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje;
- 6-Masa parandaluese dhe dënuese ndaj gjuhës diskriminuese ndaj grave në institucionet lokale;
- 7-Raportim në baza vjetore pranë Kuvendit Komunal nga KKS (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi), QPS (Qendra për Punë Sociale) dhe Komandanti i stacionit të Policisë lidhur me rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj;
- 8-Përkrahje financiare strehimores së viktimave të dhunës në familje dhe mbështetje për viktimat e dhunës;
- 9-Identifikim dhe përkrahje për nënat vetushqyese;
- 10-Të organizohen aktivitete të ngjashme si ajo “Java e gruas” ose “Java kundër stigmës” në nivel komunal.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi këshilltarëve nga radhët e LDK-së fillimisht e ka dëgjuar një formë të rezolutës gojarisht, ndërkohë ka arritur një kërkesë e quajtur si deklaratë, e pas saj kanë arritur disa rekomandime të përmbledhura në dhjetë pika, kështu që ne kemi qëndrim që të dëgjojmë të gjithë këshilltarët, formën e diskutimit. Nisur nga rekomandimet që keni sjellë këtu, për fat janë të rregulluara me ligjet e Republikës së Kosovës, e për këtë mund të na informojnë në detaje Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Arsimit që ka buxhetin specifik, ku nuk mund të kalosh këtë buxhet pa përfshirë edhe gjininë femërore. Po ashtu edhe në biznes ka përkrahje të

gjinisë femërore. Kur jemi te subvencionimi kjo kategori ka gëzuar tretman të veçantë, gjë e cila është paraqitur edhe në media, gjinia femërore është subvencionuar dhe ka përkrahje të vazhdueshme në veçanti nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Kështu që janë disa pika të cilat janë në ekzekutim nga Ekzekutivi i Komunës, përndryshe ka edhe pika që janë të rëndësishme rreth investimeve në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe tema që mund të jenë të rëndësishme për Komunën tonë. Republika e Kosovës ka Ligjin për barazi gjinore i cili mund të thuhet se ndoshta është më avancuari në rajon, ndërsa sa zbatohet ai lë hapësirë për të diskutuar. Ne mendojmë se intervenimi politik korrekt do të përmirësonte përfaqësimin gjinorë që e kemi në nivel vendi por edhe në nivel komunal dhe ky fenomen i përfaqësimit gjinor pa dashur të bëjë marketing politik asnjë partie politike, por është karakteristikë që kuotën gjinore vetëm dy partitë politike e kanë përfshirë edhe në subjektet e tyre politike. Ky përfaqësim gjinor fillon nga subjektet politike, nëse aty përfaqësohen mirë atëherë natyrisht se kjo do të manifestohet në organet tjera. Kështu që po dëgjojmë diskutimet dhe pastaj do të dalim me një qëndrim rreth rekomandimeve të propozuara.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, ka marrë një letër rekomandim nga subjekti LVV për miratimin e disa rekomandimeve të cilat u lexuan në fillim të mbledhjes. Si përkrahje që duhet ti jepet gjinisë femërore nuk donë diskutim, mirëpo dhjetë pikat e paraqitura për miratim sipas rekomandimit, mendoj se të gjitha, përjashtuar njëërën, janë të parapara me ligjet në fuqi. Kështu që mendoj se kanë mundur të përmbledhën të gjitha në një pikë dhe të kërkojmë vetëm zbatimin e tyre konform ligjeve. Zyra për barazi gjinore, aq sa jam i njoftuar ekziston në Komunë dhe është e emëruar zyrtarja për barazi gjinor, mirëpo deri më tani si Kuvend nuk kemi pasur ndonjë kërkesë apo ndonjë iniciativë që ka arritur në Kuvend nga kjo zyrë, e që do të duhej ta mbështesnim. Sa i përket përkrahjes së gjinisë femërore në biznes, e di që edhe me rregulloret e brendshme femra avancohet me dy ose tri pikë në poentim si bartëse e biznesit, por vetëm kërkojmë që kjo të zbatohet, e që më konkretisht në nivelin lokal mund të na njoftoj Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik. E di që nivel nacional, femra bartëse e biznesit ka përparësi në konkurrim të një biznesi. Për masat parandaluese dhe denigruese për gjuhën diskriminuese ekziston ligji përkatës dhe ai duhet të zbatohet, përmban edhe sanksionet penale për ofendimet apo shpifjet që mund të bëhen, pra edhe për këtë pikë themi se ekziston ligji kështu që nuk kemi se çka të rekomandojmë për miratim. Sa i përket përkrahjes financiare për strehimoren e viktimave, Podujeva nuk ka strehimore të viktimave, ndërsa niveli nacional e ka strehimoren për viktimë, sepse ekziston buxheti prej nivelit qendror, e që si Kuvend i Komunës nuk kemi pasur ndonjë kërkesë për përkrahje apo nuk ka ndonjë vendim të Asociacionit të Komunave të Kosovës për participim financiar në strehimoren qendrore, andaj për të miratuar këtë rekomandim, fillimisht Komuna e Podujevës do të duhej të themelojë qendrën strehimore, pastaj të shikoj për ndarjen e buxhetit, sepse nuk mund të planifikojmë buxhet kur nuk kemi strehimore të viktimave.

Buxheti regjional nuk ndahet në Komunën e Podujevës, sepse si Komunë bëjmë pjesë në regjionin e Prishtinës, në kuadër të të cilit janë edhe komunat (Lipjan, Fushë Kosova, Drenasi, Obiliqi) kështu që mendoj se duhet të jetë koordinim në mes Kryetarëve të Komunave apo Kryesuesëve të Kuvendeve dhe besoj se edhe Komuna e Podujevës do të jepte mbështetje nëse të gjithë participojnë, për të ndarë buxhet për Nivel qendrorë, por që nuk kemi kërkesë për fuqizim të buxhetit nga Niveli qendror dhe ne nuk kemi strehimore komunale, e nëse është e arsyeshme duhet të bëjmë këtë strehimore, por nuk kemi. Raportimi nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, kërkesa për miratim sipas rekomandimit, është e paraparë me dispozita ligjore e që është raportimi dy herë gjatë vitit, gjë e cila po ashtu është paraparë edhe me Planin e punës së Kuvendit të Komunës. Në KKSB duhet të raportohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë publike,

dua të them se pika 7 ku figuron raportimi 1 herë duhet të bëhet 2 herë, sepse është në kundërshtim me planet ekzistuese. Sa i përket përkrahjes, prej të gjitha pikave, vetëm pika nën numrin rendor 10 që i takon Zyrës për barazi gjinore është një prej pikave që mund të diskutohet dhe të merret parasysh sepse ka të bëjë me organizime dhe aktivitete të ndryshme që i referohen gruas.

Në mandatin e kaluar gratë asambleiste prej të gjitha subjekteve politike kanë ndërmarrë një iniciativë për ditën e gruas dhe i kemi mbështetur, ku këshilltarja znj. Mrika Thaçi, e ka dhënë një kontribut për një organizim që e kanë pas dhe ne i kemi mbështetë si Kuvend, iniciativë dhe organizim i tillë mund të ndërmerret edhe tani dhe do ta ketë mbështetjen e pakontestueshme në suaza të autorizimeve ligjore dhe mundësive buxhetore. Përndryshe mendoj se Kuvendi i Komunës apo secili nga ne që ka përgatitje profesionale, nëse kërkojmë për të miratuar rekomandime të ligjeve që janë në fuqi dalim si jo profesional, nuk është problemi se nuk jemi për miratimin e këtyre pikave, gjithsesi jemi, mirëpo për gjëra të tilla i kemi ligjet në fuqi që e rregullojnë këtë çështje, duke përfshirë edhe sanksionimin në rastet e shkeljeve të ndryshme. Meqë që ekziston Ligji për barazi gjinore, ne nuk mund të miratojmë rekomandime që janë të parapara me këtë ligj ngase parashihen me vet ligjin, akt i cili është më i fuqishëm sesa çdo akt tjetër, rregulloret, udhëzimet administrative, rekomandimet etj. Konsideroj se gjinia femërore, pa diskutim ka mbështetjen e Grupeve të këshilltarëve çdo kërkesë, por që brenda këtij mandati nuk kemi asnjë kërkesë, qoftë nga gratë asambleiste, qoftë iniciativave, rrjeteve të gruas, por mbështetjen do ta kenë kurdo që paraqesin kërkesa në këtë drejtim. Këto pika janë në kuadër të ligjeve përkatëse në fuqi, andaj duke përjashtuar pikën 10, kërkesë e jona është që të zbatohen të gjitha këto ligje, siç janë Ligji për barazi gjinore, Ligji për gjuhët zyrtare etj, e që duhet të zbatohen dhe nuk ka çka të diskutohet rreth kësaj, si dhe ndaj atyre që nuk i zbatojnë, duhet iniciuar procedurat përkatëse ligjore, ashtu siç duhet vepruar menjëherë në rast se i shkelet e drejta e një gruaje apo një zyrtareje në nivel komunal, në administratë.

z. Adnan Zymeri, theksoi, fillimisht besoj është e nevojshme dhe e dobishme të dihet që në legjislacionin aktual konceptet themelore sa i përket kësaj fushe janë të definuara me Ligjin për barazi gjinore, ku neni 1 pika 2 e këtij ligji thotë se, ky ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Neni 1 pika 1 gjithashtu definon që nëpërmes këtij ligji garantohet, mbrohet dhe promovohet barazia midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillim demokratik.

Po ashtu në kuadër të Zyrës së Kryeministrit funksionon edhe Agjencia për Barazi Gjinore, kompetencat e së cilës rregullohen me ligjin e lartcekur. Kjo mbetet ana e shkruar, ndërsa në pjesën praktike, duke filluar nga nivelet e larta qeveritare e deri te nivelet më të ulëta ekzekutive, si shoqëri kemi bërë gjeneralisht pak në këtë drejtim, mirëpo pavarësisht gjendjes së tanishme unë mendoj që duhet të angazhohemi së bashku për tema të tilla pasi këto tema nuk do të duhej të njihnin orientime politike, nuk do duhej shtruar për promovim të dikujt e nënvlerësim të dikujt tjetër e të ngjashme. Prandaj, në funksion të ruajtjes së kualitetit dhe në funksion të promovimit të barazisë në mes gjinive në Komunën e Podujevës, unë do të mbështesë çdo iniciativë me rekomandime të përbashkëta e unike të përfaqësuesve të Grupeve politike që vie për shqyrtim në këtë Kuvend të Komunës.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, në Kosovë ekziston Ligji për barazi gjinore, por të drejtat që burojnë nga ky ligj kanë mbetur për më shumë se një dekadë vetëm në letër. Diskriminimi, shpifja, dhuna fizike, psikike, shfrytëzimi i vajzave dhe grave, kanë ndërlidhje të ngushtë me varfërinë e shtypjes ekonomike. Se ne kemi gra të punësuar në numër të madh dhe se punëdhënësi, si në sektorin publik dhe atë privat, e konsideron problem pushimin e lehonisë.

Pra gratë në përgjithësi janë të diskriminuara si në institucione, ekonomi, pronë e po ashtu në politikë, ku po të mos ishte kuota gjinore nuk do të propozoheshim as brenda përbrenda subjektit politik. Sa i përket çështjes së shëndetësisë në Komunën e Podujevës shumë pak bëhet për kujdesin ndaj gruas, rasti konkret është se aparati i mamografisë qëndron si suvenir kurse gratë Llapjane shpenzojnë kohë dhe para për të shkuar dhe për të ekzaminuar në Prishtinë. A ka menduar ndonjëherë ekzekutivi për nënat, gratë dhe motrat tona të viseve rurale, të ju dërgohet mamograf mobil në mënyrë që edhe ato femra të ekzaminohen dhe të kenë fatin të ekzaminohen me kohë për ndonjë ndryshim eventual, kur ndihen nevojat dhe kërkesat e shumta, sidomos kohëve të fundit që kemi rritje të përqindjes së të prekurave me sëmundjen e kancerit të gjirit.

A keni menduar ndonjëherë që në shtëpinë e shëndetit të ketë ndonjë vend ku mund të kryhet papatesti për nënat dhe motrat tona, ku ndihet nevoja për parandalimin e rasteve të prekura me kancer të organeve femërore. Si mos të jetë funksionale ekipa e patronazhit në mënyrë që edhe viset rurale të jenë të informuara për shëndetin e tyre, ku në këtë ekipë të patronazhit kanë mbetur pa punë shumë nëna dhe gra në vjeshtë të vitit 2017. Pse mos t'iu lejohet të gjitha nënave gjdhënese ta shfrytëzojnë të drejtën e pauzës dy orësh gjatë orarit të punës, pse mos të kemi stimulim të lehonave ta nxisim natalitetin në Komunën tonë, pse mos të kemi çerdhe në vise rurale, që t'i mundësohet edhe atyre nënave që të punojnë. Pra kolegë dhe kolege të nderuara opozitë dhe pozitë duhet të mendojmë më shumë për një jetë më të mirë për gratë dhe t'jua sigurojmë kushtet e tyre për një jetë më të barabartë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot jemi duke biseduar bashkërisht, respektivisht duke hapur konstatimet lidhur me temën në agjendë për të cilën propozuese është Grupi i këshilltarëve të LVV-së. Juristët sigurisht janë në dijeni se shumica e pikave të rekomanduara janë të rregulluara me ligjet përkatëse në fuqi, andaj nuk shoh se ka ndonjë lidhje kauzale në mes rekomandimeve dhe ligjeve respektive. Secili nga ne këtu jemi për përkrahje të pozitës së femrës, respektivisht gruas. Nga këndi tjetër është shumë normale por duke respektuar parimet, mos të shfrytëzohet çdo propozim këtu për elemente apo kauzë politike sikurse është rasti i tanishëm. Unë jam për një kontroll të organeve administrative, nëse na keni ftuar sot këtu për punën e qeverisjes komunale se sa po zbatojnë ligjet në fuqi. Më herët përcolla me vëmendje diskutimin e koleges nga radhët e subjektit LVV, do të thotë na keni ofruar 10 pika, dhe prej këtyre 10 pikave prita që jeni përcaktuar në ndonjëherë, pikërisht fjala është për disa prej tyre që janë të drejta që burojnë nga Ligji i punës, i cili ka rregulluar çështjen e pushimit të lehonisë, ta zëmë, e që nuk ka fuqi niveli lokal të përcaktojë politika për çështje të cilat janë të rregulluara me ligj, andaj unë jam kundër këtyre 10 pikave pasi që nuk shoh asnjë prej tyre që nuk janë të rregulluara me ligj.

znj.Adelinë Stublla, sqarim, desha të theksoj se strehimorja është regjionale, ku shumë gra të Komunës së Podujevës strehohen në strehimore dhe mbesin duke u endur andej - kënde, ku kemi pasur edhe informacione në bazë të raportimit. Zyra për barazi gjinore ekziston por fatkeqësisht është vetëm e emëruar prandaj kërkojmë fuqizimin e saj. Sa i përket raportimit jemi në dijeni që parashihet të bëhet dy herë gjatë vitit, por me theks të veçantë ishte raportimi për dhunën në familje. Sa i përket subvencionit që u përmend është ai subvencionim që e marrin prapë ata burra në atë mënyrë që ju si administratë komunale u thoni që të aplikojnë në emër të gruas për të përfutur më lehtë. Gjithashtu kam kërkuar edhe formimin e mekanizmit kundër dhunës në familje më herët në seancën e parafundit, në pikën në të ndryshme, por nuk ka pas ndonjë debat për këtë. Edhe nëse ekzistojnë këto ligje, në shumë komuna, përfshirë edhe Komunën e Prishtinës janë duke mbajtur seanca të njëjta.

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, kisha mëdyshjen të flas apo jo sepse nuk kam çfarë të them për këtë temë, por të them të drejtën nuk po parapëlqej të luaj rolin e viktimës. Thjesht dua të jap një opinion timin personal lidhur me këtë çështje mjaftë të ndjeshme. Shkelja e të drejtave të grave dihet botërisht, ndodhë në tërë botën, pa përjashtuar edhe Kosovën, pyetja madhore që shpeshherë duhet parashtruar është, pse po ndodhë kjo. Atëherë është çështje e perceptimit të mentalitetit, bindjesh dhe qëndrimesh të përcjella brez pas brezi ku dihet dhe jam shumë e vetëdijshme që nevojitet shumë kohë për të ndryshuar kjo. A thua kush ka thënë se gjinia mashkullore duhet pyetur se kur do të dalësh, ku do të dalësh, çka do të bësh, pse do të bësh, çka të studiosh apo çfarë të punosh, apo të mos punosh fare, a e dini se çka thonë, kanë thënë vetëm meshkujt dhe a e dini pse , sepse u ka konvnuar atyre. Për ta ndryshuar këtë realitet duhet ndërhyrë në shumë instanca, duke filluar tek përrallat ku gruaja e mirë është ajo që kujdeset për burrin dhe fëmijët, gatuan dhe pastron dhe babait i duhet qetësi për të pushuar se është lodhur në punë, a thua gruaja nuk paska punuar asgjë, pastaj në libra, duke hekurosuar rrobat paraqesin gruan, ndërsa para televizorit babai thua se do ta ndryshojë botën me lajmet që dëgjon. Muhabetet në shtëpi dhe në kafe ku thuhet se për edukimin jo të mirë e fëmijës përgjegjës është nëna, ndërsa babai, heroi vetëm sa arrin ta fajësojë nënën. Tani mos të flasim edhe për institucione ku i njëjti mentalitet mendoj se bartet edhe aty, mirëpo nuk mund të themi se është aq keq që të trajtohet si çështje e jashtëzakonshme, sepse e cekëm edhe më herët se kjo është një problematikë botërore, e që e përsërisë se edhe Kosova nuk bën përjashtim. Mendoj se para se të flasim shumë duhet të punojmë shumë në këtë drejtim, mendoj se puna më e madhe që duhet bërë është me vajzat dhe djemtë e rinj që ta çrrënjisin këtë mentalitet se te tjerët nuk mund t'i ndryshosh, e në këtë rast funksionon vetëm ligji ose kuota gjinore. Në fakt nuk është dashur për të kërkuar as barazi, as kuota gjinore, as ligje tjera për barazi gjinore, as gjëra tjera kot, por vetëm mundësi të barabarta, e të tjerat me shumë punë është dashur me i dëshmuar vet. Për fund kam një këshillë, duke filluar nga vetja, për të gjitha gratë, mos kërkonit të drejta, dhe a e dini pse, sepse duke e bërë këtë, palën e kundërt po e vendosni si pronar të këtyre drejtave dhe mandej vendosni se a do t'u japin apo jo. Atëherë mos kërkonit por merreni atë që ju takon, duke imponuar dhe duke dëshmuar se mund të ia dilni.

z.Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, jemi thirrur në këtë mbledhje të jashtëzakonshme për një çështje, për çka mendoj se nuk kemi asgjë të jashtëzakonshme, por kur fillojnë temat të cilat janë përditshmëri për profesionistët shëndetësor dhe për ne që kemi obligim të shprehim së paku punën e tyre të përditshme që ata bëjnë, mendoj se ka nevojë opinionin e gjerë për t'u informuar, por nuk mendoj se profesionistët shëndetësor kanë nevojë që ne tu shpjegojmë atyre se çfarë punësh dhe cilat punë kryhen nga institucionet tona. Respekt për këshilltarët e Kuvendit dhe ata që merren me shëndetësi dhe flasin dhe punojnë për shëndetësi, por megjithatë më duhet që për disa çështje që mendoj se janë më shumë profesionale, t'u them me qëllim që mos të zgjojmë mëdyshje që në sistemin shëndetësor është aq keq puna. Kur u ngrit çështja e një organizimi të një mamografi, ju e dini se në vitin 2017 ka qenë një kampanjë ku me qindra gra kanë bërë këtë metodë diagnostike mamografin. Ka qenë mamografi model i cili ka qëndruar për javë të tëra në ambientet e QKMF-së dhe këtë e dinë të gjitha ato që kanë marrë shërbime prej mamografisë mobile e cila po aplikohet edhe sot, sigurisht ndoshta keni edhe informacion, është regionin e Prishtinës, ndoshta vet në Prishtinë, por e ndiej për obligim për t'ju treguar diçka për pjesën profesionale. Në takimin me profesionistët të fushës ekzakte që merren me mamografi flasin për rritjen e trendit të kalcinomave të gjirit si rezultat i përdorimit të metodës diagnostike, metodë kjo pa vend, metodë diagnostike që është përdorë si fushatë dhe e cila po rezulton me shtimin e numrit të pacientëve që kanë kalcinom të gjirit. Në këtë aspekt ju tregojë komponentën profesionale që mamografia bëhet atëherë kur ka indikacione, por së pari gjithëherë është mirë që mamografisë t'i

paraprijë një ultrazë. Mamografia si rutinë po rezulton në rritje të numrit të pacientëve me kalcinom të gjirit si rezultat i kampanjës me mamograf. Dua të ju tregojë në pika të veçanta për papatestin, i cili është një metodë diagnostike që zbulon ndryshimet kancerogjene ose ndryshimet inflamatore te gratë. Ju e dini që papatesti bëhet në institucionet që mbështeten edhe me pjesën patologjike. Nuk mundemi me krye shërbimin e papatestit sepse nuk jemi të gatshëm në nivel që e bëjmë. Papatesti bëhet në vendet ku lejohet apriori edhe punësimi por edhe veprimi dhe vlerësimet tjera. Ndërsa sa i përket Patronazhit, ai ka qenë një shërbim i caktuar shëndetësor që sipas legjislacionit përkatës përcakton vizitën shtëpiake. Çdo mjek familjar e ka obligim në përshkrimin e vendit të punës për të bërë edhe vizita shtëpiake. Ajo që u përmend si shkelje e ligjit për nënat gjë dhënëse, duhet të dini se asnjë ligj apo rregullativë ligjore nuk ekziston që nuk është zbatuar në QKMF, mendoj se ai është institucion ku zbatohet ligji dhe punëtorët nuk e di se kanë pasur ndonjëherë ndonjë vërejtje për çështjen që ju e ngritët.

z.Arbër Blaku, theksoi, i nderuar Drejtor i DSHMS, unë pajtohem me temën që ju foltë, ska diskutim se (zanatit të huaj i thuhet puna e mbarë) dhe nuk kurrëgjë të keqe këtu. Mirëpo meqë u hap tema e mamografit, jam në dijeni se në Doganën e Kosovës është një donacion që ka arritur nga Shqipëria, prej një organizate, andaj ju pyes përse është mbete që dy muaj ai aparat në Doganë.

Kryesues i Kuvendit, kërkoj nga këshilltarët e Kuvendit të respektohet Rregullorja e punës, përkatësisht diskutimet të zhvillohen vetëm për temën që është thirrë kjo seancë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, pasi që është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme dhe jemi duke diskutuar në kuptimin e qëllimit të seancës, e kam kuptuar se subjekti politik LVV ka dashur të jep në frymën e fuqizimit të barazisë gjinore që besoj se në atë frymë jemi të gjithë, qoftë si subjekte politike për fuqizim të koeficientit që e kemi të rregulluar, por si institucion jemi të obliguar.

Si këshilltar desha të potencoj këtë çështje, dokumentin e kam pranuar pasi që kam arritur në sallë, sepse po ta kisha marrë si draft para seancës do ta kisha diskutuar me iniciuesin që ligjet nuk kontestohen sa të jenë në fuqi, këtë duhet ta kemi të çartë, për arsye se shumica e pikave që duhet të miratohen janë në kuadër të legjislacionit dhe po flas në cilësinë e juristit, nuk rekomandoj apo nuk revokoj ligj që është në fuqi dhe kjo është jashtë mundësive dhe autorizimeve tona që të bëhet.

Çështja tjetër, meqë jemi mbledhur në këtë seancë për këtë qëllim të gjithë, mendoj se një vendim duhet ta marrim, me disponimin e të gjithëve, përndryshe dalim qoftë me miratim apo pa miratim. Mendoj se ky Kuvend pasi që është mbledhur për këtë çështje ka mundur të merr si rekomandim, që mendoj se është dashur të bëhet në një konsultim më të gjerë, për të shpallur një datë, një javë, “java e Gruas në Komunën e Podujevës”, pra si Kuvend mund të përcaktohem për një datë, cilëndo që e mendoni ju si këshilltarë, shembull, prej datës 01-10 mars është java e gruas, pra kjo ka mundur të jetë një prej pikave që do të përkrahje. Pra kjo do të dilte në Kuvend si datë, për t’iu bashkëngjitur më pas këtij institucioni rrjetet e organizatave joqeveritare i grave, pra ka mundur të jetë – java e gruas në Podujevë. Do të mund të themelohej edhe një komitet për barazi gjinore në kuadër të Kuvendit dhe atë me shumicë ose 100% femra. Këto do të mund të dilnin si dy pika prej këtij dokumenti, përndryshe pikat tjera të cilat janë në kuadër të ligjit, edhe pse ne jemi skeptik sepse dokumenti është i hartuar keq, jo si do të duhej të ishte. Shumë më mirë ndoshta do të kishte qenë fjala vjen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, një herë gjatë vitit brenda një periudhe të caktuar të dal me mamograf si në qendra lokale shembull, Kërpimëh, Lluzhan etj. në disa udhëkryqe që janë të rëndësishme. Me këto pika ky draft ose duhet të ndryshohet në një qëndrim të grupeve të këshilltarëve, ose nuk mund të marrim ndonjë vendim, sepse ligjet nuk kontestohen.

Prandaj Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e PDK, propozon:

-Draft dokumenti nuk mund të miratohet pa u ndërrua ligjet në fuqi;

-Të gjitha Grupet në Kuvend të përcaktohen për datën e javës së gruas;

-Të formohet një komitet për barazi gjinore me shumicë femra.

Unë bëra propozimet, ndërsa është mirë që secili Grup i këshilltarëve të deklarohej lidhur me propozimet.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, falënderoj Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për respektin dhe sqarimet në aspektin shëndetësor, jemi në dijeni për gjithçka çka bëhet dhe nuk bëhet në shëndetësi, por duhet të ndërmerret diçka, të bëhet më mirë jo vetëm për gratë por për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Jemi në dijeni edhe rreth kompetencave lidhur për çështjen e pushimit të lehonisë, se nuk i takon nivelit qendror, por duhet të ndërmerret diçka, ku edhe thuhet “Pa çaj të fëmija, nëna nuk e merr”, kështu që rasti i mamogramit në objekt e dimë që ka qenë, por unë kërkoja që të ndërmerret prapë diçka sidomos në vendet rurale. Dihet që mamogrami duhet të bëhet sidomos duke filluar në moshën 40 vjeçare rekomandohet të bëhet 1-2 herë brenda vitit, sidomos te femrat që kanë gjene me kalcinomë të gjirit.

znj. Mrika Thaçi, më bëri të dal diskutimi i znj. Arlinda Stublla ku më pëlqeu shumë, kur theksoi se nëse vlerësohen gratë vetëm se dijnë me pastru, e vërteta është se këtë e dëshmon fakti i këtyre burrave që janë këtu ulur, pra nuk ka ndonjë grua Drejtoresh, por janë vetëm burra, rast ky që e dëshmon pabarazinë gjinore.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi si duket përfunduan debatet, e hedh në votim dokumentin me rekomandimet nga Grupi i këshilltarëve të LVV .

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 8 vota ishin për, 15 vota kundër dhe 6 vota të përmbajtura, dhe nuk kalojnë rekomandimet e paraqitura nga Grupi i këshilltarëve të LVV.

Mbledhja përfundoi në ora 11:05

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0021385/19

Podujevë,

11 mars 2019

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi